



REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS

IZLAZNI - DALËSE
01-020108-15224/18

Br.sir. _____
Nr.i fq. 1
Datum 04.12.2018
Data _____
ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 30/11/2018 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 24.09.2018

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS

Udh. Prot. IZLAZNI - DALËSE
Nr. Prot. 01-020/08-15224/18
Br. str. 6
Nr. i fq. 6
Datum 04. 12. 2018
Data

ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e gjashtë të rregullt e KK-ës të mbajtur më 24.09.2018, me fillim në ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
3. Prezantimi raportit financiar nëntëmujor për periudhën janar-shtator 2018. Dhe raportit mbi pagesës se hyrave vetanake
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit i reagimit emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për objektin e komunës së Shtërpce
5. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës

Predrag Grbic: Të nderuari zëvendësit e kryetarit, këshilltar, drejtoret e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-ës dhe të gjithë të tjerë të pranishëm. Mirëdita dhe mirë se vini në seancën e tetë të rregullt të K.K. Shtërpçë. Në seancën e sotme janë të pranishëm të gjithë 15 këshilltarë, që do të thotë se kemi kuorum dhe mund të fillojmë me punë.

Rifat Rustemi: Sa për rendin e ditës, nëse ka mundësi një sqarim, plani i punës që e keni bërë për muaj korrik e keni pasur në rendin e ditës shqyrtimin e rregullores për tatim në pronë për vitin 2018 dhe në shtator ka qenë përsëri në rendin e ditës kam pritur që ne tetor është kjo pika, ndoshta ka pasur problem, nëse mund të me sqaroni pse kjo pika nuk është në rendin e ditës.

Predrag Grbic: Nuk e di z. Rustemi a keni qenë ju anëtar i komisionit për hartimin e planit të punës, kam thënë se plani i punës nuk është një letër e shenjtë dhe që ne duhet të përmbahemi atij planit të punës. Gjatë vitit, mund të ndollën disa ndryshime dhe mund të gjendet në rendin e ditës një pik që nuk është në planin e punës, gjithashtu një pik mundet mos më qenë në muajin në të cilin është caktuar, por më në një muaj tjetër.

Danijel Vuksanovic: Është aprovuar ligji i ri, në kemi obligim që deri 15. 11 2018 e aprovojme rregulloren e re tatimit në pronë që përfshinë edhe tatimi në tok, për ata kjo do të jetë në seancën e ardhshme. Duhet të caktohet shkalla e tatimit në tok.

Predrag Grbic: A lajmërohet edhe dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim pik e rendit të ditës.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua rendin e ditës

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluarë KK Shtërpce

Predrag Grbic: A lajmërohet dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush e qes në votim procesverbalin.

Konstatoj se me njëzë kemi aprovua procesverbalin

2. Prezantimi raportit financiar nëntëmujor për periudhën janar-shtator 2018. Dhe raportit mbi pagesës se hyrave vetanake

Danijel Vuksanovic: Vetëm kisha tonë që shpenzimet e ndarjes së buxhetit është 75%. Sa i përket të buxhetit total, shpenzimet janë 62%. Sa i përket të hyrave vetanake plani për vitin 2018 ka qenë 303.228€, ne për nëntët muaj kemi mbledhur 211.761€, apo 69,40%, një shumë e cila është e mire, është viti më të mirë deri tani. Nuk kam çka më shtuar, nëse dikush ka pyetje këtu jam për t'ju përgjigjur.

Rifat Rustemi: Sa për këtë raportin nëntëmujorësh, kam lexuar me vëmendjen edhe kam pas disa paqartësi edhe dje kam qenë ne komunë edhe e falënderoj drejtorin për financave, më ka dhënë shpjegime dhe detajet, sepse ka pasur edhe disa gabime teknike ndoshta edhe gjatë përkthimit edhe nuk e kam pasur bash qartë, ato që kam me thonë lidhur me këtë raport është që shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, mëditje e udhëtimit jashtë vendit, akomodimi gjatë udhëtimit jashtë vendit edhe shpenzimet të tjera udhëtimit jashtë vendit janë katër kategori, mendoj që është mirë që pak me reduktuar shpenzimet në të ardhmen, sepse në total këtyre kategorive ekonomike për nëntë muaj janë 11,584. 28€. Tani edhe derivate, bukur shumë janë edhe dreka zyrtare totali është 21339.30€, normal që duhet me pas dreka zyrtare por jo aq, është mirë me reduktuar pak shpenzime. Si do të dreka zyrtare edhe të derivate. Të mëditje udhëtimit jashtë vendit nuk e kam pa që ka udhëtime kolektive, këtu me shumë ka individual edhe më duket që janë pak shumë, edhe të telefoni, totali është diku 9.031.61€. është mirë që të këto kategori reduktohen shpenzimet në të ardhmen.

Predrag Grbic: Nëse ka mundësi në do të zvogëlojmë shpenzimet, sepse ka një here është pamundur për të shmangur shpenzimeve për shkak të detyrimeve që ne kemi, por e shoh dëshirën të gjitha drejtori që janë dakord që reduktohen shpenzimet. Do të vazhdojmë të shpenzojmë gjitha mjete në përputhje me nevojat që kemi. Ky raporti nuk aprovohet vetëm shqyrtohet, ashtu që do të kalojmë në pikën e ardhshme.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit i reagimit emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për objektin e komunës së Shtërpce

Sinisa Buduric: Ky plani është bërë për me mbrojtur personelin e punës në ndërtesën e komunës gjithashtu edhe personat të cilit në atë moment gjenden në ndërtesën e komunës së Shtërpces. Qëllimi i planit është që të sigurojë procedurat që duhet të respektohen gjatë një situatës së jashtëzakonshme. Ky është obligimi ynë ligjor, ashtu që ju lus që të aprovoni këtë plan.

Rifat Rustemi: Sa për këtë plan për reagimin e emergjent stafit e komunës në objektin e komunës, përgjithësi unë kam lexuar edhe nuk kam asnjë vërejtje ose më shumë diçka, është i përpiluar mirë i plotëson të gjitha kritere, nuk jam eksperti i kësaj lami gjithsej është i sqaruar mirë në detaje. Ju përgëzoj për këtë iniciativë. Ajo që kisha dashur më shumë është më shtuar sa i përket saj gjitha komuna e kanë një shtab për menaxhimin e krizave. Në kat rast pasi është edhe shefi i cili i ka përpiluar këtë planin për reagimin emergjent, kisha dashur që na sqaron pak a shumë lidhur më shtabin e krizave, në të gjitha komuna ekziston shtabi për fatkeqësi natyrore. Një plan i tillë kish qenë mirë me u bërë edhe neper shkolla edhe me pa me Agjencinë për menaxhim e krizave më bërë një trajnim neper gjitha shkolla, për me trajnuar më shumë nxënësit, mësimdhënësit edhe gjithë që punojnë aty, me u trajnuar çka me bërë në rastin e fatkeqësisë natyrore, sepse ata e kanë ato pajisje specifike, balona me ajër që janë për të kërcyer prej katit e dytë ose tret. Është mirë më marr një iniciativë edhe për shkolla edhe më bërë një plan për shkolla edhe me bërë një trajnim. Ndoshta më shumë mundet me na shtegu shefi pasi është këtu.

Afet Hasani: Pasi pyetje ka qenë e Rifatit, komiteti për menaxhimin e krizave që nuk është në komunën e Shtërpces, a kanë tjerat komuna, po a është e vërtetë, por ne jemi duke shkuar rollazi sepse në seancë e ardhshëm besoj që do të formohet komiteti për menaxhimin e krizave duke bazuar në Udhëzimin Administrativ edhe në ligjin mbi fatkeqësi natyrore që është formuar në tërë Kosovën, sa i përket për shkolla ne nuk jemi kompetent si drejtoria me bërë një plan i tillë, ato duhet të bënë drejtoria e arsimit, dhe ne si drejtoria mund të ndihmojmë në atë drejtim. Sa i përket trajnimit nxënëseve, apo stafit e shkollave, në Vushtri është e hapur për të gjithë, dhe përmes drejtorisë tonë ose agjencisë e emergjencës mundën të trajnohen atje.

Sinisa Buduric: Z. Rifat ka përmendur shkollat, çdo ndërtesa publike duhet të këtë një plan të tillë, ajo është e caktuar me ligj. Shkolla, çdo hotel, ndërtesë së policisë, postes, të gjithë duhet të kanë planin të tillë. Ky plani është vetëm për ndërtesën e komunës.

Predrag Grbic: A lajmërohet dikush për fjalë. Nëse nuk lajmërohet askush, vë në votim pikë e rendit të ditës.

Konstatohet se me njëzë kemi aprovuar këtë pikë e rendit të ditës

4. Të ndryshme.

Garip Sahiti: Unë e kam një pyetje edhe një shqetësim e qytetareve. Pyetja ka të bëjë me drejtorin e Arsimit më 5.10.2018 ka ardhur një vendim në të gjitha shkollat e komunës tonë, vendimi ka të bëjë me çështje e ditët e punës në javë edhe më normën, është i nënshkrua nga zëvendësi Sadk Imeri, në vendim parashihen disa pika të zbatimit të këtij vendimit. Njëra nga ata është se vendimi është i zbatueshëm pas nënshkrimit. Kam pyetje për drejtorin, sa po zbatohet ky vendim në shkollat tona. Ka të bëjë me mësimdhënësit cilit e kanë 20 orë, janë të detyruar që të punoj pesë ditë të javës. Unë mendoj qw duhet tqw duhet të punojnë një pjesë të javës në arsim, do të marr përgjigje nga drejtori sa është tu zbatuar ky vendim në shkollat tona, unë e kam përgjigje, por kërkoj nga drejtoria që të jep përgjigjet. Edhe një shqetësim e kam lidhur më qen endacak . Lagja Emerllahaj, për me ardhur deri në shkollë nxënësit e lagjes Emerllahaj e kalojnë një rrugë shumë të vështir, në aspektin infrastrukturës edhe çështjes së qenve endacak, ku një pjesa e prindërve janë ardhur disa here në shkollë dhe kemi biseduar me ata. Është sidomos domosdoshme një intervenim urgjent në rrugë për rregullimin e saj, sepse lagja dëshiron të organizon transportin për nxënësi, nga lagja deri në shkollë, por rruga nuk e mundëson ato, duhet një intervenim që të sanohet kjo rruga. Duhet edhe inspektorati i komunës me vëzhguar këtë vend sepse disa persona pandërgjegjshëm qesin kafshët e cilat kanë vdekur, ose pjesët tepricat kur e presin ata dhe i qesin atu dhe pastaj qen endacak janë në numrin shumë të madhe, kërkoj që ju bëhet edhe një vizitë nga komuna, më ardhur edhe me pa ku munden me intervenu, sepse këtu rrezikohet jeta e fëmijës, njëra nga shtresat më të rëndësishme e vendit tonë

Rifat Rustemi: Unë e kam tri çështje me ngrit edhe pastaj një kërkesë. E para kam marr shumë ankesa prej banoreve e f. Firajë, këtë problem e ka ngrit edhe zëvendësi i kryesuesit në një seancë e kalua, ka mungesë e ujit për pije, unë e di që komuna së paku tri here ka shpallur tender për ujësjellësin në f. Firajë. Por zgjidhje nuk u bërë deri tani, gjatë verës ka pasur informacione për keqpërdorim edhe unë e kam besuar asaj. Por qetash që jemi në sezonin e dimrit nuk besoj qe dikush e keqpërdor, vetëm nëse e len leshur pa nevojë. Kërkesa ime është që nëse ka mundësi që tani kemi hyr në sezonin e dimrit edhe është shtir me intervenua sepse ne e dimë prej ka vjen ai uji, a ka mundësi me dal dikush më evitu së pari problemin, më siguri ka dëmtim dikun ujësjellësi, nuk besoj që në pyetje është keqpërdorim ose investimi ose diçka tjetër, sepse investime ka pasur. Janë tri shkolla atu që nuk kanë ujë, shkolla e mesme edhe dy shkolla tjera. Ne e dimë që organizata ndërkombëtare çështjen e ujit edhe kanalizimit e trajtojnë si çështje e drejtës së njeriut. Kisha kërkuar, mundësisht që se paku ta dimë ku qëndron problemi, dhe pastaj nëse ka nevojë për intervenim me intervenua, nëse ka mundësi. Është me prioritet, sepse jemi tu e hi në dimër. E dyta mbrojtësi anësor, flas për një rrugë që e lidh tri luge, lagjet Rudaj, Smalaj edhe Coklar, kemi ankesa edhe mundeni me pa që ka mungesa mbrojtësve të asfaltit dhe paraqet shumë rrezik për vetura edhe këmbësor edhe për të gjitha. Nëse ka mundësi me vendos atu ku është më rizik, në kthesa. Edhe treta është rrëshqitja e tokës në lagjen Smalaj, që është një problem prej vitit 2009 deri tani, e di që komuna e ka pasur buxhetin për rastet e tilla, nuk besoj që ka përfunduar, është mirë që në të ardhmen shikohet për këtë. Edhe një kërkesë kryesuesi, ato ka të bojë më procedurat e kuvendit, në e kemi piken e ndryshme edhe kemi shfrytëzuar këtë pik për me ngrit të gjitha shqetësime që kemi pasur, kjo është në rregull, por unë nënkuptoj që para kësaj pike më qenë pika pyetje dhe kërkesa, ndoshta është mitre më praktiku këtë pik anëtarët e kuvendit nëse kanë nevojë për një sqarim, më pyet kryetarin ose drejtorët dhe të ndryshme me len e fundit, sepse kjo nënkupton nëse ka një problem i caktuar.

Kjo është vetëm një këshill nëse e bëni në rregull, nëse jo vazhdojmë kështu, nuk ka problem, sepse shumica e praktikojnë ashtu.

Arijeta Selami : Kryesues kam një kërkesë nga banoret për ekzekutivin e komunës, që në buxhetin për vitin të ardhshëm parashikohet asfaltimi e rrugës në lagjen Manaj që e lidh me lagjen Dukaj

Fikri Hasani: Desha të përgjigjem z. Rifatit për kërkesën e banorëve f. Firajë sepse ankesa e tyre është drejtuar edhe të unë, që nuk ka pasur uji i pijes, mirë por, problemi është më vite tera. Ne si komuna e kemi intervenuar në f. Firajë me një projekt diku 49,000€, edhe problemi deri diku është sanuar dhe kishte ujë të pijshëm të mjaftueshëm, mirë por, atëherë ka keqpërdorimi i ujit, sepse gjatë verës të gjitha mjedra në f. Firajë ujiten me ujë të pijshëm. Ky është një problem që ne nuk mund të zgjidhmi. Nëse nuk vetëdijesohen qytetarët për keq menaxhimin i ujit të pijshëm ne atëherë nuk mund të ndihmojmë, deri sa ankesa e fundit që ka qenë para dy dite, ka qenë për një ventil që kushtoj 10€, ka pasur një defekt shumë vogël, edhe kemi sanuar gjendjen për 5 min. Banoret f. Firajë kanë qëndruar tre dit pa ujë për një ventil i cili ka kushtuar 10 €, qashtu që është turbë me kërkuar prej komunës të rregullon një defekt i 10€ edhe më u shqetësua kaq shumë edhe me qëndrua tre dit pa ujë. Ne kemi këqyr edhe me Bifurkacionin, memorandum i cilin kemi nënshkruar para dy vite, por memorandum deri tash nuk ka rezultuar si suksesshëm, i vetmja mënyra për më zgjidh problem në f. Firajë është që të vendosen orët e ujit në të gjitha shtëpi edhe të paguhet uji me një vlerë shumë të vogël, atë here do të rregullohet ku problemi i ujit.

Predrag Grbic: Na në përbërjen e mëparshme kemi pasur pikën: pyetje dhe përgjigjet, por, nuk kemi pasur asnjë dobi nga kjo, të gjitha janë sjell në rreth. Propozimi është i mirë, por lirisht mundeni në pikën e ndryshme të drejtoni çdo kërkesë dhe pyetje që keni. Nuk jam njoftuar me problemin e ujit në Firajë, por ajo që e di unë që në fshatin e Shtërpçës, ka problem me ujin. Arsye është e qartë, që mbi dy muaj nuk ka ra shi.

Matjan Spasic: Ne e respektojmë të gjitha vendimet që marrim nga ministria e Arsimit dhe bazohemi në të gjitha ligjet që marrim prej tyre. Nëse dikush prej mësimeve ka një problem, ne kemi komisionin komunal për ankesa, ku në afatin e caktuar mundet të paraqet ankesë komisionit, dhe pastaj mund të ankohet të inspektorati në Ferizaj, dhe pastaj të zgjidhmi problemin që kemi.

Sinisa Buduric: Pyetja e parë ka qenë për qenë endacak. Ne kemi duart të lidhur, nuk mund të bëjmë asgjë lidhur me këtë çështje. Qeveria e Kosovës ka shpallur një tender dhe e ka shpërndarë zgjidhjen e këtij problemi në rejonet. Ata e kanë caktuar veterinerin, në përshkrimin e tij punës është që ai e mbledhë qentë, e kastron, dhe i vendo pulla në veshin e tyre dhe i kthen në vendin të njëjtin ku e ka marr. Unë nuk jam i kënaqur me këtë zgjidhje, sepse ata e kthejnë në vendin të njëjtin ku i kanë marr dhe ekziston rreziku që ata e kafshojnë dikonin. Sa i përket heqjes së mbeturave nga kafshatë, ajo është detyra e inspektoreve sanitar, ne me koleg do të bëjmë at punë, do të dërgojmë inspektorët edhe do të shohim çka mund të bëjmë. Sa i përket ujit, thotë sira e madhe e ka bërë veten, Edhe Shtërpçe nuk ka ujë, kemi qenë detyruar që të bëjmë reduktime çdo mbrëmje nga ora 23 deri ora 06, për me pasur ujë. Ne fshatin Firajë ka pasur disa rrjedhje ku kemi dërguar inspektorat, ata kanë dal në terren, kanë konstatuar gjendjen dhe në menjëherë kemi dërguar një kërkesë Bifurkacionit, por ata asnjëherë nuk kanë dal në terren që të

ndrequr prishje, ajo është puna e tyre. E kemi thirr edhe me telefon disa here, na kanë thonë që do të dalin në terren, por nuk ka asgjë prej asaj, ashtu që nuk di çka do të bëjë me ata. Sa i përket rrëshqitjes së dheut, në f. Brod, ne disa here jemi drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës, për ndihmën profesionale rreth kësaj, por nuk kemi mundësi që të caktojmë atë rrëshqitje, për shkak të madhësisë së lart, ata e kanë dërguar disa ekspertë të cilit ne kanë sugjeruar që të mbjellim dru, por, ajo parcela është prona private. Dhe presim ndihmën mëtejshme prej tyre.

Predrag Grbic: Lidhur më pyetje Arietes Selami, ju e dini që në seancën e kaluar kemi aprovuar buxhetin për vitin e ardhshëm, por unë kam fol shumë për me gjetur mjete nga institucionet të ndryshme dhe më siguri do të marrët parasysh kjo që keni thonë ju. Drejtori i urbanizmit nuk është këtu, por do të njoftohet me kërkesën e juaj dhe ajo do të planifikohet në projekte që do të realizohen gjatë vitit e ardhshëm. A lajmërohet dikush tjetër për fjalë? Meqë askush nuk lajmërohet, seanca e sotme ka përfunduar.

Procesmbajtësi
Staja Markovic

Kryesuesi i Kuvendit
Predrag Grbic

